

SH.A ALBPETROL

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE): “Tetra PRO” shpk me NUIS M22121029F , me adresë: Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

Tipi i Kontratës: Kontratë sherbimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-29917-11-18-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Update programi kompjuterik per menaxhimin e magazinave dhe paisja e tyre me barcod”

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 19.11.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr. 81 datë 25 Nentor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm:

1.Bashkimi i Operatorëve Ekonomik :“ INFOSOFT SYSTEMS” shpk me NUIS J61820021C dhe “InfoSoft Business Solutions” shpk me NUIS L02214022G, me vlerë oferte në total 17,194,540(shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

2.Operatori Ekonomik “KREATX” shpk me NUIS L12121023B, me vlerë oferte në total 19,020,000(nëntëmbëdhjetë milion e njëzet mijë) lekë pa TVSH

3.Operatori Ekonomik “Tetra PRO” shpk me NUIS M22121029F , me vlerë oferte në total 18,884,000(tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Bashkimi i Operatorëve Ekonomik :“ INFOSOFT SYSTEMS” shpk me NUIS J61820021C dhe “InfoSoft Business Solutions” shpk me NUIS L02214022G nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:

- BOE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, sipas kerkesave te pikes 2.3.7 te pikes 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 9 të DST-së ku cilesohet se ne autorizim duhet të jetë i paraqitur numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Dristibutorit (Adresë, website, email, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet.
- BOE nuk ka paraqitur certifikatat per Sisteme ERP te Aseteve dhe Inventareve dhe Sisteme te inventareve (Supply Chain), kjo ne kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.5. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 9 të DST-së

2.Operatori ekonomik “KREATX” shpk me NUIS L12121023B nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit , konkretisht:

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur formularin e sigurimit te ofertes sipas shtojces 3 , kjo ne kundërshtim me piken 2 germa b “Kriteret e veçanta të kualifikimit” ne DST

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “Tetra PRO” shpk me NUIS M22121029F , me adresë: Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,884,000 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.